



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 453/2 Prot

Rrëshen, më 29 . os . 2026

V E N D I M

Nr. 35 datë 26. 05. 2026

PËR

**“PËRDORIM FOND REZERVË - DHËNIE NDIHMË FINANCIARE”,
BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", në Udhëzimin nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, "Për miratimin e buxhetit 2026", VKB nr. 98, datë 10.12.2025, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", *Kërkesën nr. 753 prot, datë 12.02.2026, "Mbi vlerësimin ekonomik - social të familjes të Z. Eduart Vasej", nga sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Mbrojtjes Sociale të Bashkisë*, së bashku me projektin-vendimin e Kryetarit Bashkisë, pas diskutimeve në mbledhjen e Këshillit Bashkiak;

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorimin e fondit rezervë, në shumën **110 000** (njëqind e dhjetë mijë) lekë, për dhënie ndihmë financiare, si vijon;
T'i akordojë ndihmë financiare, Z. Eduart Vasej me ID; H81007024, njësia administrative Rubik, për kushte të vështira jetese, për periudhën Shkurt - Dhjetor 2026, me nga 10 000 lekë/muaj
 - a. **Paksim:** Fondi rezervë; (A1133 00 2133001 01 V491AAA..604) në vlerën; **110 000** lekë
 - b. **Shtohet:** Pagesë; (AA133 00 2133001 01 V111AAA...606) në vlerën; **110 000** lekë
2. Pagesa të kalojë, në degën e Postës Mirditë, zyra Postare Rrëshen
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, (Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tatim Taksave)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar!

SEKRETAR

Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



ADRESA: QESHË "ABAT DOÇI", RRËSHEN

tel dhe fax : (00355) 09 2162233

KRYETAR

Aleksandër RICA KU

www.bashkiamirdite.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

Nr 753/prot

Rreshen me 18/02/2026

Nr. 20 date. 18.02.2026

“PËR PERDORIM FOND REZERVE ”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ne ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", 87/2025, "Per buxhetin e vitit 2026" "Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, "Për zbatimin e buxhetit 2026", ,ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2026", në kërkesen , nr.753 prot, datë.12.02.2026, te AASNS, "Kerkese per ndihme financiare", këshilli i bashkisë Mirditë pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i bashkise;

V E N D O S I:

I-Të perdorë nga fondi Rezerve shumën 110 000 lekë, për dhënie ndihmë financiare si më poshte;

1.Të japë ndihmë financiare familjes së z.Eduart Vasej (H81007024G), banuese Rubik , NJA Rubik, per kushte te veshtira jetese, per periudhen shkur-dhjetor 2026, me nga 10000 leke ne muaji.

a-Paksim:fondi rezervë (AI133 00 2133001 01 V491AAA..604) për shumën 110 000 lekë
b-Shtohet (AA133 00 2133001 01 V111AAA.....606) për shumën 110 000 lekë

.2. Pagesa te kaloje ne degen e Postes Mirdite, zyra Postare Rreshen .

II-.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksave.

III-.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Gaspër TOPOLLAJ

KRYETARI

Aleksander PICAKU

Paraqiten projektin

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Dr.Juridike, prok, protokoll: M.Topollaj

KRYETARI
Albert MELYSHI

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.al



Nr. 753 Prot
Dt. 12.02.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITE
NJËSIA ADMINISTRATIVE RUBIK
Zyra e Ndhmës Ekonomike dhe Mbrojtjes Sociale.



Nr _____ Prot.

Rubik, më ____/____/2026

Lënda: Kërkesë për mbështetje financiare
Drejtuar: Drejtorisë së Financës

Lidhur me paraqitjen e personit pranë Njesisë Administrative, ju paraqesim vlerësimin social-ekonomik për rastin e mëposhtëm:

Z. Eduart Vasej, 50 vjeç, banues në Tiranë, është i ndarë nga bashkëshortja dhe aktualisht ndodhet në kushte të rënda sociale dhe ekonomike. Pas ndarjes martesore, personi ka mbetur pa mbështetje dhe pa strehim të qëndrueshëm. Ky person paraqet probleme serioze shëndetësore fizike, të cilat e bëjnë të paaftë për ushtrimin e aktivitetit të rregullt të punës. Megjithëse aktualisht nuk disponon dokumentacion mjekësor zyrtar që të vërtetojë paaftësinë për punë, gjendja e tij fizike është e rënduar dhe e kufizon ndjeshëm në kryerjen e aktiviteteve bazë të jetës së përditshme. Z. Eduart Vasej nuk përfiton të ardhura të rregullta dhe nuk është i përfshirë në asnjë skemë ndihme ekonomike apo pension invaliditeti. Mungesa e të ardhurave dhe pamundësia për të siguruar nevojat bazë jetësore e vendosin Eduartin në rrezik të lartë social. Gjendja e tij shëndetësore kërkon kujdes të vazhdueshëm, shpenzime për trajtime mjekësore dhe mbështetje sociale, të cilat personi nuk është në gjendje t'i përballojë.

Për sa më sipër, rekomandohet që z. Eduart Vasej të përfshihet në skemat e mbështetjes financiare dhe sociale strehim si dhe të vlerësohet për përfitim nga ndihma ekonomike dhe shërbime të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Konceptoi:

Administrator Shoqëror

Joana Marku

Lorena Doda

Miratoi: Drejtori Aurel Cupi

Përgjegjësi i Sektorit Social
Gjergj Përgjoni

Nr. 51. Prot
Dt. 11.02.2026



Data. 10.02.2026.

Kërkesë

Drejtuar : Zyres së Sherbimit Social , Njesisë Adm. Pubik
Bashkisë Mirditë .

Unë i memorizuar Eduart Vasej, me banim aktual në Tiranë dua të bëj një kërkesë tek Njësia Adm. Pubik, duke shpjeguar se kam lindur në Fierzë, Pubik, jam i martuar me një fëmijë por i ndarë nga familja ja ligjërish. Duke qenë se bashkëshortja nuk më ndihmon, duke më stresuar kam ardhur të strehohem tek shtëpia e vëllait tim në Fshatin Fierzë, për të mos u endur rrugëve mëtej Tiranë. Për një muaj po endem rrugëve dhe gjëndja ime ekonomike është shumë e keqe për të ndjekur edhe shpenzimet e proçesit të Divorcit dhe, bashkëshortja më detyron që të endem rrugës. Po kaloj një gjemolje shëndetshore shumë të keqe nuk jam dhe i aftë të punoj që të siguroj të ardhura as për shpenzime vetjake, as për ilage, as për qiranë e shtëpisë për arsyje.

Vëllai në Fierzë, Mirditë nuk mundet që të më plotsoj të gjitha kushtet për shkak të gjëndjes fizike që kam. Dëshiroj me sa mundësi të kemi të më ndihmoni që të me një strehë, ushqim, një ndihë financiare sepse dhe vëllai im nuk ka mundësi ekonomike të më ndihmojë.

Eduart Vasej